

Në zbatim të Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të Ligjit 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrit nr. 60 datë 5.4.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor” i ndryshuar, ASIG shpall konkurimin për zëvendësim të përkohshëm për pozicionin:

- Punonjës Pastrimi, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme-(një pozicion pune).

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të mos ketë qenë i dënuar;
4. Të ketë aftësi të mira komunikuese;
5. Paga për këtë pozicion: është klasa – I.

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 03/04/2018, ora 08:00 – 16:30, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, në adresën: Godina e Inovacionit, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati II, Tiranë, ose në adresën e e-mailit info@asig.gov.al, këto dokumenta:

- Kërkesë për aplikim;
 - CV;
 - Fotokopje të librezës së punës (nëse ka);
 - Vërtetimin e gjendjes gjyqësore (ose vetëdeklarim me vërtetimin e aplikimit);
 - Raport mjeko-ligjor (për aftësi në punë);
 - Kartë identiteti (fotokopje);
 - Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar.
- (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit).

Procedura e përzgjedhjes bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale dhe me intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në vlerësimin e përvojës, kualifikimin dhe aftësitë e kandidatit.

Pas verifikimit paraprak të aplikimeve, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor do të njoftohen kandidatët e kualifikuar, si dhe data kur do të zhvillohet intervista.